



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1626/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “SE-FA Hurriyet Mh.” me seli në Menekse 2 Cd nr. 44 në Stamboll të Turqisë, të cilin e përfaqëson Liman Musa avokat në Ferizaj, kundër debitorit “The North Unicorn” SH.P.K., me seli në zonën industriale në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Arianit Koci dhe Granit Vokshi avokatë me seli rr. “Robert Doll” nr. 19, Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1944/2022 të datës 29.09.2023, me datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit SE-FA Hurriyet Mh. me seli në Menekse 2 Cd nr. 44 në Stamboll të Turqisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1944/2022 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1944/2022 të datës 29.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbarimit “The North Unicorn” SH.P.K, me seli në Prishtinë, ka anuluar në tërësi urdhrin përmbarimor P.nr.210/2022 të datës 21.04.2022 të përmbaruesit privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj dhe ka përfunduar në tërësi procedurën përmbarimore. Në pikën II të dispozitivit detyrohet kreditori i përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit t’ia paguaj debitorit të përmbarimit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “SE-FA Hurriyet Mh.” me seli në Menekse 2 Cd nr. 44 në Stamboll të Turqisë, me datë 20.04.2022 përmes autorizuarit të tij ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit “The North Unicorn” SH.P.K., me seli në zonën industriale në Prishtinë, në bazë të faturës nr. SEF2020000000450 të datës 13.05.2020, në shumën e përgjithshme të borxhit prej 450 Euro.

Përmbartuesi privat Besnik Aliu, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.210/2022 të datës 21.04.2022, ka lejuar përmbartimin kundër debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitori me datë 05.05.2022 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se fatura lëndore është lëshuar në gjuhën turke, e cila nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, pra në gjuhën të cilën ai nuk e kupton. Më tutje ka shtuar se në rastet tjera i ka paguar të gjitha faturat kur kreditori i ka lëshuara ato në gjuhën të cilën e kupton debitori. Përveç kësaj, ai ka kundërshtuar se fatura lëndore nuk është e nënshkruar dhe e vulosur nga debitori, që nënkupton se ajo faturë është e papranuar nga ai dhe se ajo është tërësisht e panjohur për atë. Për fund ka argumentuar se borxhi nuk mund të jetë në lartësinë e kërkuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 17.05.2022, duke e kundërshtuar prapësimin me arsyetimin se i njëjti është i pabazuar dhe i pa argumentuar, andaj ka propozuar që i njëjti të refuzohet dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1944/2022 të datës 29.09.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit të përmbartimit “The North Unicorn” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka anuluar në tërësi urdhrin përmbartimor P.nr.210/2022 të datës 21.04.2022 të përmbartuesit privat Besnik Aliu me seli në Ferizaj dhe ka përfunduar në tërësi procedurën përmbartimore. Në pikën II të dispozitivit ka detyruar kreditorin e përmbartimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit t’ia paguaj debitorit të përmbartimit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas

prapësimi të debitorit në shumë të përgjithshme prej 104 €, në emër të përpilimit të prapësimi nga avokati, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se prapësimi i debitorit është i bazuar, për faktin se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi nuk është e nënshkruar, as e vulosur nga debitori, ku rezulton se debitori nuk e ka pranuar faturën lëndore, detyrimin që rrjedh nga e njëjta. Si rezultat i mungesë së pranimit të faturës, vjen deri te mungesa e tipareve të përmbarueshmërisë së dokumenteve të besueshëm, pengese kjo e pakapërcyeshme ligjore, për këtë nuk mund të lejohet përmbarimi. Mbi bazën e kësaj rrethane gjykata e shkallës së parë ka anuluar urdhrin përmbarimor dhe ka përfunduar procedurën përmbarimore në tërësi.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimi të debitorit. Sipas vlerësimi të kësaj gjykate, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit, dhe e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga pala debitore, gjë që faturën kontestuese e bënë të papranueshme dhe si e tillë e njëjta nuk i përmbush kushtet e dokumentit të besueshëm.

Dhomat e Shkallës së Dytë sqaron se në raportin afarist mes palëve lëshimi i faturës duhet t'i përmbajë të gjitha kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 3 i LPP-së i cili përcakton se "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*". Ndërsa me paragrafin 1, pika 1.1 të nenit 29, parashihet se: Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: "*1.1. Kambialet dhe çeket me potest dhe **faturë kthyese**, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës*".

Bazuar në kushtet e përcaktuara me këtë dispozitë ligjore fatura nuk mund të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm nëse mungon ndonjë nga kriteret që e bënë atë të përshtatshme për përmbarim. Fakti se debitori nuk e ka pranuar faturën, nuk i jep faturës fuqinë e dokumentit të besueshëm dhe i njëjti nuk mund të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Sipas qëndrimit juridik të kësaj gjykate, në procedurën përmbarimore që rrjedh nga një raport afarist palët duhet t'i

mbështesin pretendimet e tyre mbi dokumente të cilat janë të pranueshme për ndjekjen e procedurës në gjykatë. Pra, që fatura të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm do të duhej që e njëjta të jetë e pranuar nga pala debitorë duke përmbajtur kështu nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, i vlerësoi pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit lidhur me atë se debitori ka pranuarin mallin se kjo vërtetohet nga CMR-i i cili është e nënshkruar dhe vulosura nga debitori, mirëpo të njëjtat i refuzoj si të pabazuara për faktin se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport me ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe për lartësinë e detyrimit monetar që buron nga fatura kontestuese.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1626/2023 me datë 19.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha